



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

**Mundësi për studime master në Institutin e Filmit FIOFA në Ohër,
Maqedoni**

Ministria e Arsimit dhe Sportit, njofton të gjithë të interesuarit për studime në fushën e skenografisë dhe produksionit artistik, se Instituti i Filmit FIOFA në Ohër, ofron kurse për diploma Master në fushat e sipërcituara, për rreth 20 studentë, për të cilët qeveria maqedonase siguron bursa të plota, pa dallim kombësie.

Instituti FIOFA është krijuar nga bashkëpunimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës së Republikës së Maqedonisë dhe Akademisë së Arteve në Pragë.

Më shumë detaje për Institutin FIOFA dhe kushtet e aplikimit, gjenden në faqen e web: www.filmacademyohrid.com

DREJTORIA E ARSIMIT TË LARTË DHE SHKENCËS